



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 10 shkurt 2015
Nr. ref.:VTK769/15

VENDIM PËR HEQJE TË KËRKESËS NGA LISTA

në

Rastin Nr. KI145/14

Parashtrues

Behxhet Mustafa

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Themelore në
Prishtinë, A. nr. 1780/14, të 12 shtatorit 2014**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është z. Behxhet Mustafa, me vendbanim në Prishtinë.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, A. nr. 1780/14, të 12 shtatorit 2014, i cili i ishte dorëzuar atij më 13 shtator 2014.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së procedurës së zgjedhjes së rektorit të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", me të cilën pretendohet se është shkelur neni 20 (4.1) i Statutit të Universitetit të Prishtinës. Parashtruesi i kërkesës nuk i është referuar asnjë dispozite kushtetuese.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 24 shtator 2014, parashtruesi dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 30 shtator 2014, parashtruesi parashtrroi kërkesë për tërheqjen e kërkesës së tij, sepse dëshiron t'i shterojë mjetet juridike.
7. Më 7 tetor 2014, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. GJR. KI145/14, caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin Nr. KSH. KI145/14, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Arta Rama-Hajrizi.
8. Më 9 tetor 2014, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës.
9. Më 9 dhjetor 2014, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i paraqiti Gjykatës rekomandimin për papranueshmërinë e kërkesës.

Pranueshmëria e kërkesës

10. Gjykata vëren se, në mënyrë që ta vlerësojë pranueshmërinë, duhet të shqyrtojë kriteret për pranueshmëri të përcaktuara me Kushtetutë, Ligj dhe me Rregullore të punës.
11. Në rastin në fjalë, parashtruesi i kërkesës konteston procedurën e zgjedhjes së rektorit të Universitetit të Prishtinës, "Hasan Prishtina". Megjithatë, më 30 shtator 2014, parashtruesi i kërkesës parashtrroi kërkesë për të tërhequr kërkesën e tij për shkak se dëshiron t'i shterojë mjetet juridike.

12. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet rregullit 32 (Tërheqja e kërkesës dhe përgjigjes) së Rregullores së punës, i cili parashikon:

“(1) Pala mund të tërheqë kërkesën ose përgjigjen e parashtruar për atë kërkesë në çdo kohë para fillimit të seancës dëgjimore, ose në çdo kohë para marrjes së vendimit nga Gjykata, nëse vendimi merret pa seancë dëgjimore.

(2) Pavarësisht tërheqjes së kërkesës, Gjykata mund të përcaktojë të vendosë përkitazi me të.

(3) Në rast të tillë, Gjykata vendos pa seancë dëgjimore, duke u bazuar vetëm në kërkesë, në përgjigjet e parashtruara dhe në çfarëdo dokumentesh që i janë bashkëngjitur asaj”.

13. Prandaj, Gjykata konkludon se nuk ka rrethana të jashtëzakonshme lidhur me respektimin e të drejtave të njeriut të cilat do të kërkonin shqyrtim të mëtejshëm të kërkesës dhe, kështu vendos ta heqë kërkesën nga lista në pajtim me rregullin 32 të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 113.7 të Kushtetutës, nenit 47 të Ligjit dhe rregullit 36 (3) e) të Rregullores së punës, më 23 shtator 2014, njëzëri

VENDOS

- I. TA HEQË kërkesën nga lista;
- II. T’UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Ivan Čukalović



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Prof. dr. Enver Hasani